

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarve I.Z. nga Gjilani, lagja "...", pa nr., A.S. nga Gjilani, lagja "...", rruga "...", nr. ... dhe N.R. nga Gjilani, rruga "...", nr. ...për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje, nga neni 189 par. 2 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.187/2016, të datës 24.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), me datë 08.02.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.187/2016, të datës 24.11.2016, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.187/2016, të datës 24.11.2016, të akuzuarit I.Z., A.S. dhe N.R. i ka shpallë fajtorë për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par. 1 nën par. 1.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe i ka gjykuar secilin veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, ekzekutimi i të cilave është shtyrë në afat prej nga 2 (dy) vite, me kushte që të akuzuarit brenda kësaj periudhe nuk do të kryejnë vepra tjera penale. Janë obliguar që secili veç e veç të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 20 € në emër të paushallit gjyqësorë, si dhe shpenzimet tjera procedurale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. I dëmtuari H.B., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe atë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionet penale, me

propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin i ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarve t'i shqiptoj dënim të njëjtë por me burg efektiv.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën me shkrim PPA/II.nr.1608/2016, të datës 22.12.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim Prokurori me ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë përkundër vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, të akuzuarve nuk iu ka shqiptuar dënimin e merituar sipas ligjit, sepse ka shqiptuar dënim me kusht kur nga të gjitha rrethanat e kryerjes së veprës penale të lëndimit të rëndë trupor, në pa mëdyshje shihet se dënimi është jo proporcional dhe jo adekuat me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të kryerësve dhe pasojat e shkaktuara me këtë vepër penale dhe si i tillë Prokurori konsideron se ky dënim nuk do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale të kësaj natyre. Po ashtu, Prokurori pretendon se cilat janë ato rrethana posaçërisht lehtësuese që kanë ndikuar të gjykata që të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim të këtillë të kushtëzuar, gjersa të gjitha rrethanat e rastit konkret flasin se dënimi ka qenë dashtë të jetë shumë më i ashpër, përkatësisht proporcional me shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërisë dhe pasojave të shkaktuara me këtë vepër penale.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, nuk janë të bazuara, gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese ka vlerësuar

faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, se janë të moshës relativisht të re dhe të gjendjes së rëndë materiale, se është hera e parë që ndeshen me ligjin, kanë premtuar se një gjë e tillë më kurrë nuk do të përsëritet, si dhe faktin se pas këtij rasti të njëjtë nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje tjetër, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë lëndimet e shkaktuara të dëmtuarit dhe faktin se edhe këta të akuzuar kanë lëndime të rënda trupore dhe në prani të këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë të njëjtëve iu ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Vlerësimin e këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv, siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e Prokurorit. Prandaj duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, rrethanat të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesën e Prokurorit nuk është theksuar ndonjë rrethanë veçanërisht e re rënduese e cila nuk ka qenë objekt vlerësimi nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe që kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi tjetër, kolegji penal i kësaj gjykate konstaton se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar ndaj të akuzuarve, është i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit, duke pasur parasysh si rrethanë veçanërisht lehtësuese faktin se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë dhe faktin se kanë premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla penale, prandaj kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar me burgim e i kushtëzuar nga gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarve është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tyre dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e neni 401 të KPPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1576/16 të datës 08.02.2017**

**Bashkë. profesional**  
**Hysni Ismaili**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Shqipe Qerimi**

**Kryetari i kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Ferit Osmani**